



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. __, datë __. __. 2024

PËR

ZYRËN E RIKUPERIMIT TË ASETEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, e Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave për krijimin, organizimin, funksionimin, përcaktimin e përgjegjësive dhe procedurave të bashkëpunimit të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve.

Neni 2 Misioni

Misioni kryesor i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (në vijim ZRA) është gjurmimi dhe identifikimi i të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Pasuri”: janë të drejta apo interesa pasurore të çdo lloji mbi një aset, qoftë ky i luajtshëm ose i paluajtshëm, i trupëzuar ose i patrupëzuar, material ose jomaterial, përfshirë dhe ato të evidentuara në formë elektronike apo numerike (digjitale), duke përfshirë, por pa u

kufizuar në instrumente të tilla si kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur apo vlerë tjetër që buron prej tyre.

- b) “Përfitime të tjera pasurore”: pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interesi, dividendi ose të ardhurat e tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.
- c) “Shkëmbim kryesisht/vullnetar i informacionit”: shkëmbim pa ndonjë kërkesë për këtë qëllim, i atij lloji informacioni dhe inteligjence apo edhe prove të cilat janë në dispozicion të autoriteteve shqiptare dhe që ata besojnë se mund të jenë të dobishme në hetimin e procedimeve penale ose mund të ndihmojnë në përfundimin e hetimeve penale në juridiksione të tjera, i cili mund të ndahet me autoritetet e huaja sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- ç) “Informacion dhe inteligjencë”: çdo lloji informacioni ose të dhënash që mbahen nga autoritetet ligjzbatuese, autoritetet publike ose nga subjektet private dhe që janë në dispozicion të autoriteteve ligjzbatuese pa marrë masa shtrënguese.

Neni 4

Fusha e Veprimtarisë

1. ZRA e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Në përmbushje të misionit të saj, ZRA bashkëpunon me zyrat homologe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rrjetet ndërkombëtare për rikuperimin e aseteve.

Neni 5

Parimet bazë

Parimet bazë mbi të cilat udhëhiqet ZRA në veprimtarinë e saj janë:

- a) ligjshmëria;
- b) efikasiteti dhe ekonomizimi;
- c) barazia dhe mosdiskriminimi
- ç) objektivitet dhe paanshmëri;
- d) profesionalizmi;
- dh) transparenca;
- e) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ë) besimi reciprok;
- f) ruajtja e konfidencialitetit dhe sekretit hetimor;
- g) paanshmëria politike;

- gj) llogaridhënia;
- h) ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit;
- i) mbrojtja e interesit publik.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi i ZRA

1. ZRA, si strukturë e posaçme qendrore në Policinë e Shtetit, është organi përgjegjës për procesin e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një veprë penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit, dhe gëzon pavarësi operationale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
2. Struktura dhe organika e ZRA miratohen nga Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
3. Drejtori i ZRA emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
4. Buxheti i ZRA është pjesë e programit buxhetor të emërtuar “Policia e Shtetit”.
5. Procedurat standarde të veprimit, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me propozimin e drejtorit të ZRA brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Drejtori i ZRA

1. Drejtori i ZRA përfaqëson pikën qendrore të kontaktit të Republikës së Shqipërisë, me zyrat homologe të vendeve të tjera, si dhe rrjetet ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve.
2. Drejtori i ZRA është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së ZRA.

Neni 8

Statusi dhe atributet e punonjësve të ZRA

1. Oficerët e policisë në ZRA përzgjidhen nga radhët e punonjësve të policisë, që plotësojnë kriteret për t'u emëruar në Policinë e Shtetit, në përputhje me ligjet e aktet nënligjore në fuqi.
2. Kandidatët për punonjës të ZRA i nënshtrohen verifikimit të personalitetit të tyre nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen policore në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.
3. Transferimi i oficerëve të ZRA në një detyrë tjetër në Policinë e Shtetit bëhet në përputhje me procedurën e parashikuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim, të oficerit të ZRA.

4. Marrja e masave disiplinore për punonjësit e ZRA dhe ankimi ndaj tyre bëhet në bazë të ligjit që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.
5. Oficerët e ZRA gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjislacionin procedural penal dhe ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

KREU III

PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE DHE DETYRAT

Neni 9

Kompetencat

ZRA është përgjegjëse për:

- a) Gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente;
- b) Shkëmbimin e informacionit, kryesisht ose sipas kërkesës, që lehtëson gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit;
- c) Krijimin e mekanizmit për shkëmbimin e praktikave në lidhje me mënyrat për të përmirësuar efektivitetin e përpjekjeve për gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose janë të lidhura me to;
- ç) Mbledhjen e statistikave lidhur me gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to;
- d) Bashkëpunimin me rrjetet ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve dhe me organizma të tjera që konsiderohen të përshtatshëm në funksion të kryerjes së veprimtarisë së ZRA.

Neni 10

Detyrat

1. Detyrat e ZRA-së janë:
 - a) Merr masa dhe kryen veprime për gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave, pasurisë ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, brenda vendit ose jashtë tij, në pronësi të një personi juridik ose personi fizik, shtetas shqiptar, shtetas i huaj apo pa shtetësi, si dhe për nevojat e procedurës së sekuestrimit, konfiskimit, pavarësisht pranisë ose jo të një vendimi penal, e cila rregullohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

- b) Është e autorizuar si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të ketë akses në regjistrin qendror të llogarive bankare dhe regjistrin e pronarëve përfitues;
 - c) Shkëmben informacion dhe analiza financiare me Agjencinë e Inteligjencës Financiare;
 - ç) Shkëmben informacion dhe praktika me njësitë e huaja homologe në funksion të hetimit financiar të ndërmarrë nga organet përkatëse kombëtare, në varësi të detyrimeve të ngjashme të konfidencialitetit. Informacioni i ofruar mund të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë ligj, në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë të ZRA. Informacioni mund të shpërndalet vetëm me pëlqimin paraprak të palëve;
 - d) Shkëmben informacion, të dhëna dhe përvoja me autoritete kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit;
 - dh) Administron dhe analizon informacione dhe raporte, si dhe kryen analiza të thelluara për çështje të lidhura me pasurinë që është produkt i veprimtarisë kriminale, duke përdorur forma, metoda e mjete pune të analizës dhe vlerësimit të informacionit sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për këtë qëllim;
 - e) Mbledh dhe përpunon rregullisht statistika në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike;
2. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij neni bëhet në bazë të kërkesës së marrë ose në përputhje me praktikatat e shkëmbimit kryesisht të informacionit sipas përcaktimit në këtë ligj.

Neni 11

Aksesi dhe shkëmbimi i informacionit

1. ZRA ka akses të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit dhe në çdo lloj regjistri publik, lidhur me të dhënat për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të çdo lloji, në të dhënat mbi të drejta ose interesa pasurore të çdo lloji mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, regjistra të përqendruar të dhënash për kontrata dhe/ose detyrime të subjekteve private me organe të shtetit, regjistrat noterialë, të dhënat mbi automjetet dhe lejet e drejtimit, të dhënat tatimore dhe doganore, të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale.
2. Institucionet apo subjektet që disponojnë këto të dhëna janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të japin aksesin e kërkuar në informacion për ZRA.
3. Për informacione e të dhëna të tjera, në bazat e të dhënave apo sistemet e klasifikuara “sekret shtetëror”, ZRA mund të ketë akses, nëse ky veprim është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në marrëveshje me institucionin përkatës.
4. ZRA ndan kryesisht ose mbi bazë të një kërkesë nga organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar, informacione apo të dhëna, të disponueshme apo që mund të përftohen përmes bashkëpunimit me zyrat e huaja homologe, në funksion të gjurmimit dhe identifikimit

të të ardhurave, pasurisë ose përfitimeve të tjera që lindin nga një vepër penale ose janë të lidhura më të, që mund të jetë objekt i sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

Neni 12

Bashkëpunimi me rrjetet ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve

1. ZRA në përmbushje të misionit dhe përgjegjësiive ligjore bashkëpunon me pikat e kontaktit të agjencive të zbatimit të ligjit në Rrjetin Ndërinstitucional të Rikuperimit të Aseteve Camden, rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, si dhe rrjetet e tjera të rikuperimit të aseteve
2. Bashkëpunimi me rrjetet e rikuperimit të aseteve synon përmirësimin e njohurive të ndërsjella të metodave dhe teknikave të bashkëpunimit operacional në fushën e gjurmimit dhe identifikimit ndërkufitar të të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, aktivitet kriminal ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit.

Neni 13

Shkëmbimi i praktikave

ZRA shkëmben praktika me zyrat e huaja homologe për të përmirësuar efektivitetin e veprimeve për identifikimin e të ardhurave, pasurive ose përfitimeve të tjera pasurore që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, të cilat mund t'i nënshtrohen sekuestrimit ose konfiskimit nga organet kompetente.

Neni 14

Mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale

1. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave personale dhe atyre të klasifikuara “sekret shtetëror”, kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, për informacionin e klasifikuar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.
2. Vetëm personat e autorizuar dhe të trajnuar nga ZRA mund të kenë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit që kryejnë, sipas qëllimeve të këtij ligji.
3. Te dhënat personale ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar, por jo më shumë se 5 vite.

KREU IV
BASHKËPUNIMI ME ORGANET DHE INSTITUCIONET KOMBËTARE

Neni 15

Pikat e kontaktit për ZRA

1. Organet kombëtare të sistemit të drejtësisë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, që marrin pjesë në hetimin financiar dhe autoritetet e tjera kombëtare bashkëpunimi me të cilët i shërben përmbushjes së misionit dhe përgjegjësive të ZRA, me kërkesë të ZRA, caktojnë një pikë kontakti.
2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij informojnë menjëherë ZRA, në rast ndryshimi të pikës së tyre të kontaktit.

Neni 16

Mënyra e komunikimit

1. ZRA komunikon në rrugë elektronike të sigurt nëpërmjet pikave të kontaktit të institucioneve kombëtare sipas pikës 1 të nenit 15, bazuar mbi një kërkesë të paraqitur në formën e firmës digjitale e cila përmban të gjitha elementët e një kërkesë zyrtare ose të një kërkesë të verifikuar përmes një certifikate digjitale të lëshuar në përputhje me ligjin.
2. Kur komunikimi në rrugë elektronike si më sipër nuk është i mundur, komunikimi ndërmjet ZRA dhe pikave të kontaktit kryhet përmes korrespondencës zyrtare shkresore.
3. Në rastet urgjente, kopja e skanuar e kërkesës mund të dërgohet përmes email-it zyrtar me kusht që kërkesa origjinale të përcillet menjëherë përmes postës në ZRA.

Neni 17

Dorëzimi i kërkesave pranë ZRA-së

1. Organet kombëtare të drejtësisë dhe organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar përmes pikave të kontaktit mund të paraqesin në mënyrë elektronike kërkesat në ZRA për të marrë informacion mbi pasurinë në pronësi të personit juridik ose personit fizik, shtetas shqiptar, person pa shtetësi ose të huaj.
2. Kërkesa, në varësi të rrethanave të rastit, duhet të përmbushë elementët e kërkuar për kërkesat drejtuar ZRA-së, në përputhje me përcaktimet e aktit nënligjor të miratuar për këtë qëllim.
3. ZRA ia përcjell pa vonesë kërkesën ZRA-së së shtetit të huaj dhe pas marrjes së përgjigjes ia përcjell atë menjëherë organit kërkues, përmes pikës së kontaktit.

Neni 18

Dorëzimi i njoftimeve në ZRA

1. Ministria e Drejtësisë informon pa vonesë ZRA përmes pikës së kontaktit për kërkesën e pranuar nga jashtë për ndihmë juridike ndërkombëtare e cila ka të bëjë me sekuestrimin ose konfiskimin.

2. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara informon ZRA përmes pikës së kontaktit mbi vendimet e përcjella nga gjykata në kuadër të veprimtarisë së saj.

KREU V

BASHKËPUNIMI ME ZRA TË HUAJA

Neni 19

Mënyra e komunikimit

1. Për çështjet e kompetencës së saj, ZRA komunikon drejtpërdrejt me zyrat e huaja homologe në mënyra elektronike zyrtare.
2. Komunikimi mes zyrave të rikuperimit të aseteve bëhet përmes kanaleve të komunikimit elektronik.
3. Kur komunikimi elektronik nuk është i mundur, zbatohet forma zyrtare e komunikimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 20

Gjuha e përdorur

Komunikimi ndërmjet ZRA-ve bëhet në gjuhën zyrtare të dakordësuar nga palët e përfshira.

Neni 21

Kërkesat e ardhura nga jashtë

1. Bashkëpunimi ndërmjet ZRA-ve do të ndërmerret në përputhje me instrumentet dhe praktikat më të evropiane në lidhje me thjeshtimin e shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës.
2. Elementët që duhet të përmbajë kërkesa përcaktohen përmes një akti nënligjor të miratuar për këtë qëllim.
3. Krahas kërkesës, për veprën penale të cilës i referohet kërkesa, paraqitet edhe përmbajtja e dispozitave përkatëse të legjislacionit penal të shtetit kërkuar.

Neni 22

Afatet për shqyrtimin e kërkesave

Afatet për shqyrtimin e kërkesave drejtuar ZRA janë:

- a) 10 ditë nga momenti i marrjes së kërkesës, për kërkesat që nuk janë urgjente;
- b) 1 ditë nga momenti i marrjes së kërkesës, për kërkesat urgjente të lidhura me kategori të tilla informacioni për të cilat ZRA ka akses të menjëhershëm dhe tre ditë nga marrja e kërkesës nëse ZRA duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të dhënë informacion përmes autoriteteve të tjera kombëtare;

- c) Kur ekzistojnë arsye për të cilat kërkesa e marrë nuk mund të përmbushet brenda afatit të përcaktuar, ose kur kërkesa e pranuar nuk mund të përmbushet në asnjë rast, ZRA është e detyruar të njoftojë ZRA që ka paraqitur kërkesën, pa vonesë.

Neni 23

Refuzimi i një kërkesë të dërguar nga një ZRA e huaj

1. Kërkesa e dërguar nga një ZRA e huaj mund të refuzohet në rastet e mëposhtme:
 - a) Kur mund të dëmtohen interesat thelbësore të sigurisë kombëtare të shtetit të cilit i kërkohet informacion;
 - b) Kur mund të dëmtohet ecuria e një hetimi aktual, e një operacioni të inteligjencës në fushën penale ose siguria e individëve;
 - c) Kur qëllimi për të cilën kërkohet informacioni është jo në proporcion me interesat e ligjshme të një personi, ose është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa
 - ç) Është në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik;
 - d) Rrezikon të cenojë sovranitetin, sigurinë kombëtare, rendin publik ose interesa të tjerë thelbësorë të shtetit.
2. Për refuzimin e kërkesës njoftohet pa vonesë ZRA e huaj me arsyetimin përkatës.

KREU VI

BAZA E TË DHËNAVE ELEKTRONIKE

Neni 24

Baza e të dhënave statistikore

1. ZRA mbledh, ruan dhe përpunon statistika të siguruar nga organet gjyqësore kombëtare dhe organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar, dhe përditëson një bazë elektronike të dhënash mbi:
 - a) kërkesat e marra dhe të dërguara nga dhe për ZRA homologe;
 - b) kërkesat e marra dhe të dërguara në kuadër të ndërveprimit të ZRA brenda vendit;
 - c) marrjen dhe dërgimin e raporteve mbi praktikën e ndjekur;
 - ç) marrjen dhe dërgimin e informacionit të ndarë kryesisht;
 - d) statistika mbi masat e sekuestrimit dhe konfiskimit.

KREU VII

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 25

1. Drejtori i ZRA emërohet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Deri në plotësimin e strukturës së ZRA, Drejtori i ZRA do të mbështetet në detyrat e tij nga punonjës të strukturave të analizës së informacionit kriminal dhe hetimit në Policinë e Shtetit.

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e zbatim të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA